



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BKËSHILLI BASHKIAK

## V E N D I M

**Nr. 133 , datë 30.09. 2020**

### **“PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR VENDOSJEN E INSTALACIONIT “WOODEN CLOUD” NË SHESHIN “SKËNDERBEJ”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Vendimit nr. 143, datë 18.01.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës paraprake (pjesa e parë dhe pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tiranë, Qarku Tiranë, Vendimit nr. 650, datë 31.07.2013 i Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 31.07.2013 “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e tretë, e katërt dhe e pestë) të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Tiranë, Qarku Tiranë dhe memos nr. 14745/1, datë 03.09.2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

## V E N D O S I:

1. Dhënie e pëlqimit për vendosjen e instalacionit “Wooden Cloud” me vendndodhje në Sheshin “Skënderbej”.
2. Vendosja e instalacionit “Wooden Cloud”, duhet të shoqërohet me gjithë dokumentacionit e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhënien me Publikun dhe Jashtë, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

**K R Y E T A R**

**TONI GOGU**